

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Vahid Halili, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Have Haliti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në lëndën penale kunder të akuzuarit D.P. ,nga Kollashini, Republika e Malit të Zi, për shkak të vepres penale grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankeses se mbrojtësit të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.250/16 të datës 29.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 09 shkurt 2017, mori këtë ;

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si **e pabazuar** ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.P., ndersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.250/16 të datës 29.11.2016 **VERTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Pejë **PKR.nr.250/16** të dates 29.11.2016, i akuzuari D.P., është shpallur fajtor për veprën penale grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të cilin i është shqiptuar dënimi me burgim në kohezgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 30.10.2016 e tutje.

I akuzuari është obliguar që të i paguaj shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarise perfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 (pesëdhjetë) Euro, e të gjitha keto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara F.H., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit D.P. – av.Sh.G. nga Peja, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkalles së parë ta ndryshojë dhe të akuzuarit të i shqiptojë një dënim burgu më i butë e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Prokurori i Apelit i Kosoves, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit D.P., me shkresën e vet PPA/I.nr.50/17 të datës 23.01.2017 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te vertetohet.

Gjykata e Apelit, në këtë çështje penale konformë nenit 390 par.1 të KPP të Kosovës, ka caktuar seancën e kolegjit, në të cilën morën pjesë i akuzuari D.P. dhe mbrojtësi i tij me autorizim av.K.B. dhe përkthyesi i gjykatës Elez Baxhaku, ndërsa Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë dhe e dëmtuara F.H., e cila nga fletëkthesa ekziston konstatimi se e njëjta ka vdekur. I akuzuari dhe mbrojtësi i tij mbetën pranë pretendimeve nga ankesë duke propozuar që të aprovohet e njëjta dhe të i shqiptohet dënimi më i ulët me burg.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPPK-se dhe pas vleresimit të pretendimeve të cekura në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit gjeti se :

-Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkalles se pare nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosoves të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 384 të KPPK-se dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dem të akuzuarit të cilat kishin me kushteuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vleresimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet sepse i akuzuari D.P. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe gjyqtari si dhe prokuroria është pajtuar me një pohim të tillë ngase e njëjta është bërë pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe ka mbeshtetur në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

Sipas vleresimit të Gjykates së Apelit të Kosoves, pretendimet e përmendura ankimore nga ana e mbrojtësit të të akuzuarit se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës, premtimin se nuk do të kryejë vepra penale në të ardhmen, se është i papunë, se me pare nuk ka qenë i gjykuar nuk qëndrojnë ngase gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit të dënimit i ka patur parasysh rrethanat të cilat cekën në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, se është i papunë, se me pare nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin ,pastaj se ka bashkëpunuar vullnetarisht me organet kompetente shtetërore, gjykata e shkalles se pare i ka patur parasysh rrethanat e rastit konkret andaj, Gjykata e Apelit e Kosoves konsideron se të njëjtat pretendime ankimore të mbrojtësit së të akuzuarit nuk janë të bazuara, ngase dënimi i është shqiptuar në kuadër të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, edhe duke patur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale kjo gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, ndaj të akuzuarit është në harmoni me intenzitetin e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij si

dhe te ndikoje edhe ne personat e tjere qe te mos kryejne vepra penale, duke konsideruar se me denimin e shqiptuar si ne dispozitiv te aktgjykimit te ankimuar do te arrihet qellimi i denimit i parapare me dispoziten e nenit 41 te KPRK-se.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit te Procedures Penale të Kosovës u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.38/17, Më 09.02.2017

Procesmbajtësi
Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Vahid Halili

Have Haliti
